

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Tërmeti" politik në Gjermani, Merz del në skenë: Dorëzimi nuk është opsion!
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/07/termeti-politik-ne-gjermani-merz-del-ne-skene-dorezimi-nuk-eshte-opsion/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:43:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 16:18:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	553ab784927e16b663b987bb697ee7fe028a7123edd995f2e4ab754c27b085d5
TEKSTI	496bd5c8bee18a27f728ffd3e0b9ba45840726632f2e31d6deb127bbe0414e48
PAMJA	60d372edf209388f9295b75a5a35a059f848b0e9538dcb9ed4ae0a3031cfb8c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d334e0f7252457e634e4d9cec7f104c3904929073314dd62eb6eb61f88c8ed75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d334e0f7252457e634e4d9cec7f104c3904929073314dd62eb6eb61f88c8ed75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“T”ërmeti” politik në Gjermani, Merz del në skenë: Dorëzimi nuk është opSION!

Botë

Publikuar: 07/09/2026

f X



Kancelari gjerman Friedrich Merz ka reaguar pas rezultatit tronditës të zgjedhjeve rajonale në Saksoni-Anhalt, ku partia e ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë (AfD), shënoi një nga fitoret më të mëdha të së djathtës ekstreme në Gjermani që prej Luftës së Dytë Botërore.

Në një deklaratë nga Berlioni, Merz pranoi se rezultati ishte një goditje e rëndë për CDU-në dhe se askush në parti nuk e kishte pritur një rezultat të tillë.

Ai e cilësoi atë si rezultatin më të keq të CDU-së prej dekadash dhe paralajmëroi se pasojat e votimit do të ndihen jo vetëm në Saksoni-Anhalt, por në të gjithë Gjermaninë dhe madje edhe në nivel ndërkombëtar.

“Jemi të gjithë thellësisht të tronditur. Nuk e prisnim një rezultat të tillë, por duhet ta pranojmë. Këto janë rregullat e demokracisë sonë”, deklaroi kancelari.

Sipas Merz, zgjedhjet kanë shkaktuar një ndryshim të rëndësishëm në sistemin politik gjerman. Ai e përshkroi rezultatin si një “zhvendosje tektonike” në sistemin e partive dhe pranoi se disfata “e ka tronditur partinë deri në themele”.

Megjithatë, Merz hodhi poshtë çdo mundësi për dorëheqje. Ai tha se është plotësisht i vendosur të vazhdojë rrugën e nisur dhe të marrë përsipër përgjegjësinë politike për situatën.

“Për mua, dorëzimi nuk është një opSION”, u shpreh Merz. “Jam i

Me të lexuarat

Rama “djeg” Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Besnik Leskaj...

Besnik Leskaj i mori në punë të birin. Postet në merrshmi i Beratit / Si ja...

Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik Rokellipadiga e...

Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t’ia dhënë...

biznesmenit Enri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

vetëdijshëm për përgjegjësinë time personale ndaj vendit dhe jam i vendosur ta marr këtë përgjegjësi.”

Kancelari theksoi se Gjermania ka nevojë për reforma të thella dhe se humbja në zgjedhjet rajonale nuk do ta ndryshojë kursin e tij politik.

“Gjermania ka nevojë për reforma themelore dhe vendosmëria ime për t’i realizuar ato mbetet e palëkundur”, tha ai, duke shtuar se reformat lidhen drejtpërdrejt me të ardhmen e vendit dhe me mundësitë që Gjermania do t’u ofrojë fëmijëve dhe nipërve të saj.

Merz pranoi gjithashtu se qeveria nuk mund të vazhdojë sikur asgjë nuk ka ndodhur.

Sipas tij, rezultati i zgjedhjeve tregon se CDU-ja dhe qeveria federale duhet të ndryshojnë mënyrën se si komunikojnë me qytetarët dhe të përpiqen të rikthejnë besimin e humbur.

“Qeveria federale nuk duhet t’i shpjegojë reformat vetëm në mënyrë racionale. Ne duhet t’i komunikojmë ato edhe në planin emocional”, tha kancelari. Ai pranoi se për shumë gjermanë jeta e përditshme është bërë e vështirë dhe se pas zgjedhjeve është shtuar edhe frika se vendi mund të ndryshojë për keq.

“Duhet të arrijmë më shumë te njerëzit, në të gjithë dimensionin e tyre emocional”, theksoi Merz.

Kancelari mbrojti ndërkohë reformat e ndërmarra nga qeveria gjatë vitit të kaluar, duke thënë se ai vazhdon të jetë i bindur se vendimet e marra kanë qenë të drejta. Ai tha se pikërisht këto reforma duhet të zbatohen tani dhe se me këtë qëndrim do të ulet në bisedimet me partnerin e koalicionit qeverisës.

Merz u përpoq gjithashtu të vendoste kufij të qartë për ndryshimet politike që mund të sjellë rezultati i zgjedhjeve. Ai theksoi se, edhe pse shumicat parlamentare dhe qeveritë ndryshojnë, parimet themelore të demokracisë gjermane nuk mund të vihen në pikëpyetje.

“Shumicat ndryshojnë. Qeveritë dhe politikat e tyre i nënshtrohen gjithmonë gjykimit të votuesve. Ky është vetë themeli i demokracisë. Por ka një gjë që nuk mund të vihet në diskutim: vlerat e Ligjit Themelor, Kushtetutës sonë dhe rregullat e bashkëjetesës sonë”, deklaroi ai.

Sipas kancelarit, pushteti në Gjermani duhet të merret përmes institucioneve dhe rregullave demokratike, ndërsa pakica politike nuk duhet të trajtohet si armike e shumicës.

“Çdo qeveri duhet t’i përmbahet Ligjit Themelor”, theksoi Merz, duke shtuar se qeveria do të garantojë respektimin e Kushtetutës dhe të rendit demokratik.

Ai siguroi gjithashtu partnerët ndërkombëtarë se Gjermania do të ruajë orientimin e saj evropian.

“Për shkak të historisë sonë, Gjermania ka një përgjegjësi të veçantë. Ne do ta ruajmë rendin politik dhe ankorimin tonë në Europë”, tha kancelari.

Merz foli edhe për sigurinë e brendshme, duke e cilësuar kërcënimin si “shumë konkret”. Në të njëjtën kohë, ai garantoj se fitorja e AfD-së në Saksoni-Anhalt nuk do të ndryshojë politikën e qeverisë federale ndaj Ukrainës.

“Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Ukrainën”, deklaroi ai.

Duke iu referuar Rosisë, Merz tha se fitorja e AfD-së në landin lindor të Gjermanisë është pritur me kënaqësi nga Moska.

“Dua të jem shumë i qartë: 2 500 kilometra në lindje nga këtu ka dikush që është veçanërisht i kënaqur me këtë rezultat zgjedhor”, tha kancelari, duke iu referuar Rosisë dhe duke paralajmëruar njëkohësisht për përpjekjet për destabilizimin e Gjermanisë.

Në përfundim, Merz tha se rezultati duhet marrë jashtëzakonisht seriozisht dhe se CDU-ja duhet të punojë për të rikthyer besimin e qytetarëve.

Ai përsëriti se nuk po mendon për dorëheqjen dhe se nuk do të heqë dorë nga kursi i reformave.

“Duhet të përmirësohemi të gjithë së bashku”, tha ai, duke nënvizuar se përballë situatës së re politike nevojiten përkushtim, empati dhe aftësi për t’iu drejtuar qytetarëve jo vetëm me argumente, por edhe duke kuptuar shqetësimet dhe emocionet e tyre.

Ndërkohë, kandidati i CDU-së në Saksoni-Anhalt, Sven Schulze, pranoi shkallën e rëndë të humbjes, duke deklaruar se partia e tij nuk ka më mandat për të qeverisur.

“Ne nuk kemi asnjë mandat për të qeverisur. Mandati për të qeverisur tani i takon AfD-së”, tha Schulze.

Pavarësisht rezultatit historik të së djathtës ekstreme, Merz këmbëngul se përgjigjja e tij nuk do të jetë tërheqja, por përpjekja për të ndryshuar kursin e qeverisë, për të rikthyer besimin e qytetarëve dhe për të zbatuar reformat që, sipas tij, Gjermania nuk mund t’i shtyjë më.

TAG:

Gjermani

Merz

Tërmeti politik

Të ngjashme

Trump paralajmëron Zelenskyn:
Ndaloni sulmet ndaj naftës ruse,
po dëmtoni ekonominë botërore

Angli/ Dënohet agjenti imobilar, i
siguroi shqiptarëve 19 shtëpi për
të mbjelle kanabis me vlerë dy
milione sterlina

Tri humbje dhe më afër fitores se
kurrë: Pse 2027 mund të jetë viti i
Marine Le Pen

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.